




FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

Newsletter Numër 10



“Ti nuk do të jesh kurrë vetëm!”



“Rindërtojmë së bashku!”

NË FOKUS

Rindërtojmë të ardhmen!

HISTORI NJERËZORE

Shtëpi e Ëmbla Shtëpi!

TË REJA NGA PROJEKTET

Modeli i Ri i Zhvillimit!

A E DINI SE?

Jemi në garë me kohën dhe me veten!



NË FOKUS

Rindërtojmë të ardhmen!

Dija është ajo që ka bërë diferencën midis popujve dhe brezave, ndaj investimi në edukim është më i miri për ringritje dhe zhvillim pas tërmetit. Kjo është arsyeja pse prioriteti i parë i Qeverisë është rindërtimi i infrastrukturës arsimore, ku vetëm me financim nga buxheti i shtetit, FSHZH po rindërton 37 objekte arsimore, për të akomoduar 30 mijë fëmijë në bashkitë e prekura nga tërmeti.

Bazuar në parimin “Ndërto përsëri më mirë”, standardi i shkollave të reja është ai Evropian, i pakrahasueshëm me kushtet para tërmetit. Në 100 mijë m² ndërtim do të ngrihen 550 klasa me 24 nxënës për klasë, 130 laboratorë, 40 palestra e terrene sportive, ngrohje qendore, efikasitet të lartë energjie, infrastrukturë bashkëkohore të rrjeteve të furnizimit.

Aktualisht, për të 37 objektet janë hartuar projektet, lidhur kontratat, marrë lejet përkatëse, zgjidhur problematikat me sheshet dhe po punohet me intesitet të lartë për ndërtimin dhe dorëzimin e tyre.

Falë angazhimit të të gjitha ekipeve, do bëhet e mundur që në fund të Nëntorit të çelin dyert një numër i konsiderueshëm shkollash dhe brenda këtij viti të mbyllen pothuajse të gjitha objektet e financuar nga buxheti i shtetit.

Kjo do të bënte të mundur që 30 mijë fëmijët nga zonat e prekura, vitin e ri ta fillojnë në një shkollë të re, për një të ardhme më të mirë, pasi siç thoshte i madhi Naim, “Drita e diturisë, para do na shpjerë”.



Dan Bajrami, Kurbin



Ramazan Subashi, Vorë



Vëllezërit Haradinaj, Durrës



Besnike Xhixha dhe Gjyle Domi, janë dy komshie të mira, që jeta i ka sjellë të jetojnë prej vitesh të vetme në shtëpitë e tyre, në Maminas të Shijakut.

Mbrëmjen e 25 Nëntorit 2019 asnjëra prej tyre nuk do e mendonte që tërmeti që shkundi tokën, do t'i bënte të gdiheshin të nesërmen “në rrugë të madhe”. Të strehuara fillimisht në të afërmit e tyre, tashmë ky moment i vështirë është në harresë e sipër me shtëpitë e rindërtuara që kanë marrë jetë në truallin ku nuk ka më asnjë shenjë të banesave të vjetra.

Me bastunin që e ndihmon të hedhë hapat pas vështirësive fizike të pleqërisë dhe një jete jo të lehtë, nënë Besnikja i gëzohet shtëpisë së re.

“Ju jam shumë falenderuese të gjithëve, një më një që kanë punuar këtu - shprehet ajo. U bë më e bukur se shtëpia që kisha”.

Nënë Besnikja

Ndërkohë shumë pranë saj, Nënë Gjylja në këmbë “inspekton” vetë punimet e fundit, për të hyrë në strehën e re.

“Nuk kam fjalë, veç falenderime. Jam kaq e kënaqur, punë shumë e mirë”. *Nënë Gjylja*

Të gjendura përherë pranë skuadrave të rindërtimit, nënot japin veç “urata”, duke pritur me padurim për të hyrë në shtëpitë e reja që nuk ju përngjajnë në asnjë drejtim ngrehinave të para.

Nënë Besnikja dhe nënë Gjylja qëndruan të forta e durimplotë përballë kësaj sfide që fati jua solli, sepse ato nuk ngelën kurrë vetëm. Ne ishim të gjithë aty në këto muaj të vështirë, “nën të njëjtën çati”, për të kaluar sfidën e rradhës.





Tërmeti i Nëntorit ishte një goditje e rëndë, por nga ana tjetër nëpërmjet “Programit të Rindërtimit”, krijon mundësinë që ringritja pas goditjes të jetë sipas një modeli të ri zhvillimi duke materializuar vizionin e qeverisjes për Fushë Krujë, Thumanën, Durrësin, Shqipërinë që Duam!

Pjesë e programit të rindërtimit, zona e re në Fushë Krujë e pozicionuar në kryqëzimin e rrugës nacionale dhe unazeës, me një sipërfaqe prej 10 ha, do të akomodojë 128 familje në banesa individuale dhe 100 familje në pallate, duke patur gjithë infrastrukturën e shërbimeve sociale, arsimore, tregëtare, hapësirave të gjelbra e sportive, rrugë, trotuare e parkime.

Pasi përfunduar procedurat e prokurimit e hartuar projektet, prej disa muajsh po merr jetë ndërtimi i këtij modeli të ri zhvillimi, ku aktualisht kanë përfunduar 100% rrytet e infrastrukturës nëntokësore, është përfunduar 90% e infrastrukturës rrugore, duke pritur të përfundojë ndërtimi i banesave për të mbyllur përfundimisht rifiniturat dhe mobilimin urban. Ka filluar ndërtimi i 128 banesave individuale dhe shumë shpejt fillon ndërtimi i 15 pallateve me 100 apartamente.

Të gjitha ekipet e rindërtimit, janë duke punuar ditë e natë, në mënyrë që fundi i këtij viti t’i gjejë të gjitha banesat individuale të përfunduara dhe në pranverën e vitit tjetër të kemi dhe pallatet e gatshme për banorët e rinj. “Programi i Rindërtimit” në Fushë Krujë dhe të gjitha zonat e reja për zhvillim, përveç rindërtimit të banesave më të mira nga ato që kishin më parë, do të sjellë dhe një cilësi të pakrahasueshme jetese në këto zona, për një jetë komunitare dhe një të ardhme më të mirë.



4

A E DINI SE?

Jemi në garë me kohën dhe me veten!

Ky vit që po lemë pas përveç sfidave të rindërtimit pas tërmetit të 26 Nëntorit, na ka vënë përballë dhe sfidave për përballimin e pandemisë Covid-19 dhe efekteve që ajo po jep në shëndetin, ekonominë dhe mënyrën tonë të jetesës.

Në mënyrë të veçantë kjo sfidë është emergjente për fëmijët në zonat e prekura nga tërmeti, ku kushtet e krijuara i kanë vënë në vështirësi të mëdha për kryerjen e procesit mësimor, duke i vendosur ekipet e rindërtimit në një situatë që duhet të jenë në garë me veten dhe kohën.

Kjo kërkon prej secilit të bëjë diçka më shumë, më mirë, më shpejt, pa çenuar standardin dhe cilësinë e vendosur, duke dhënë maksimumin nga vetja.

Prandaj jemi mirënjohës për të gjithë bashkëpunëtorët tanë, projektuesit, mbikqyrësit dhe të 37 operatorët ekonomikë që janë duke punuar për të bërë të mundur realizimin e ndërtimit dhe në mënyrë të veçantë falenderojmë kompanitë që janë në pararojë të rindërtimit të shkollave.



Shaqe Mazreku, Durrës



Gosë, Kavajë



Neim Babameto, Durrës



Llesh Nik Daka, Lezhë

Falenderojmë ekipin e Arkonstudio, për ecurinë shumë të mirë në shkollën “Shaqe Mazreku”.

Falenderojmë ekipin e Leon Konstruksion, për ecurinë shumë të mirë në shkollën “Gosë Kavajë”.

Falenderojmë ekipin e Fushës, për ecurinë shumë të mirë në shkollën “Neim Babameto”.

Falenderojmë ekipin e Ulëza Ndërtim, për ecurinë shumë të mirë në shkollën “Llesh Nik Daka”.